

VENDIM
Nr.8, datë 7.1.2005

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë kombëtare për personat me aftësi të kufizuar.
 2. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministria e Financave, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e kësaj strategjie.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano